

PROGRAME STUDIUMI NË DEPARTAMENTIN E SHKENCAVE ZOOTEKNIKE UBT



PSE UNIVERSITETI BUJQËSOR?

- ✓ Diplomat në UBT njihen plotësisht jashtë vendit.
- ✓ Mbi 30 universitete partnere nga Europa dhe mundësi për ERASMUS për 1 simestër dhe vazhdim të studimeve Master
- ✓ Ka tarifa të përgjysmuara të studimeve.
- ✓ Ofron bursa për studentët më të mirë

MUNDËSI PUNËSIMI PËR TË DIPLOMUARIT:

- Drejtoritë, zyrat, agropikat e bujqësisë, blegtorisë dhe në shërbimin e ekstensionit në nivelet qendrore, rajonale dhe ato të bashkive.
- Institucionet dhe laboratorët e sigurisë ushqimore (drejtoritë, inspektoriate dhe laboratorët) për sigurinë e ushqimeve për blegtorinë dhe të produkteve shtazore.
- Kompanitë dhe bizneset e vëndit dhe të huaja të fushës së bujqësisë, blegtorisë, agroturizmit dhe industrisë agroushqimore.
- Zyrat private të konsulencës dhe ekspertizës për bujqësinë dhe blegtorinë.
- Vetpunësim duke krijuar biznese të reja në bujqësi, blegtori, agroturizëm dhe siguri ushqimore.

Në departamentin e Shkencave Zooteknike (DSHZ) të Universitetit Bujqësor të Tiranës filloi zbatimi në Janar 2021 i projektit internacional afat gjatë (3-4 vjet), në kuadër të Programit Erasmus+ të Bashkimit Europian.

Përmes këtij projekti do të zhvillohet dhe implementohet, përherë të parë në vendin tonë në fushën e bujqësisë, modeli gjerman Dual i studimeve universitare, me anë të programeve Bachelor në fushën e 'Zooteknisë dhe sigurisë së produkteve blegtorale' dhe atë të 'Bioteknologjisë Zooveterinare'. Në këto programe Duale, studentët do të studiojnë duke kombinuar, në mënyrë thuasë të barabartë (50:50), teorinë me praktikën, ç'ka rrit cilësinë e formimit të tyre profesional, ndihmon punësimin e tyre të menjëhershëm pas studimeve, si dhe zhvillon aftësitë e tyre për të krijuar bizneset e tyre.

- ✓ Modernizimi i programeve të studimeve universitare dhe i praktikës profesionale direkt në biznese, sipas sistemit DUAL të Gjermanisë dhe Finlandës;
- ✓ Krijimi i mundësive studentëve të departamentit tonë për të kryer një semester në universitetet partnere në Gjermani dhe Finlandë
- ✓ Krijimi i mundësive për shkëmbinim e pedagogëve, si dhe për të ftuar profesorë nga Gjermania dhe Finlanda për leksione me studentët e departamentit tonë
- ✓ Modernizimi i kabinetëve të IT, Mësimi Online (Distance Learning) dhe të laboratorëve mësimore shkencore për studentët
- ✓ Bashkëpunimin me kompanitë dhe bizneset e fushës së bujqësisë, blegtorisë, industrisë ushqimore si dhe me institucionet shtetërore qendrore, rajonale dhe bashkiake për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve dhe lehtësimin e punësimi të shpejtë të tyre pas përfundimit të studimeve

